



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:075930

Datë: 25.07.2024

Numri i dokumentit: 05984278

KPPP.nr.464/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.SH. "A.G.S" (A.F.K. BI), me NUI: 810891392, me seli në rr. "Bajram Bahtiri" nr.71, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valon Mehmeti, avokat nga Mitrovica, kundër debitorit "McCroft Tobacco Kosovo Limited", me NRB: 70341182, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.K., jurist nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.34/22 të datës 10.02.2022, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 25.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "McCroft Tobacco Kosovo Limited", ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr. 34/22 i datës 10.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.SH. "A.G.S" (A.F.K. BI), ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.34/22 të datës 10.02.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 269 të datës 01.09.2021; me të cilën është urdhëruar debitori që nga dita e pranimit të urdhrin t'ia paguaj kreditorit shumën prej 33,243.55 € me kamatë prej 8%, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtu që inkasimi i borxhit nga përmbartuesi privat të bëhet me bllokimin dhe ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e veçantë të përmbartuesit

privat, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në pagesën e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar që kreditori në rastin konkret nuk e ka bashkëngjitur faturën në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me dispozitën e nenit 37 të LPP-së. Më tutje ka shtuar që në propozimin për përmbartim është theksuar që debitori ka qenë i obliguar të paguaj shumën prej 33,245.55 €, në emër të ofrimit të shërbimeve të transportit nga Gjilani deri në Tiranë në terminalin Vorë, ndërsa në faturën kontestuese objekti i faturës ka të bëjë me transportin vendor, gjë e cila bie në kundërshtim me propozimin dhe faturën. Ka shtuar që palët ndërgjyqëse nuk kanë asnjë raport kontraktual lidhur me çështjen e transportimit vendor apo ndërkombëtar të mallrave, duke e kontestuar nënshkrimin e faturës, meqenëse e njëjta nuk dihet se nga kush është nënshkruar dhe në çfarë cilësie, e po ashtu ka deklaruar që fatura nuk përmban vulën e debitorit.

Në fund ka theksuar që në rastin konkret nuk dihet se për cilin objekt apo shërbim është lëshuar fatura dhe mbi bazën e cilës kontratë është realizuar, pasi që palët nuk kanë pasur bashkëpunim për shërbim për një shumë mbi 33,000.00 €, pa një marrëveshje paraprake mes tyre. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për përmbartim, si dhe të detyrohet kreditori t'ia kompensojë shpenzimet procedurale debitorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se dëshmitë përcjellëse i janë bashkëngjitur përmbartuesit privat në shkresa të lëndës në kopje origjinale. Ndërsa lidhur me vërejtjet sa i përket faktit se në faturën e lëshuar nga kreditori në pjesën e përshkrimit përdoret termi Transport Vendor edhe pse shërbimi është ofruar jashtë vendit, ka theksuar se programi i financave në biznesin e tyre nuk posedon shifra tjera. Sa i përket pretendimit të debitorit se ndërmjet palëve nuk ka ekzistuar marrëdhënia kontraktuale, ka theksuar që një gjë e tillë nuk qëndron, për shkak se në mes të palëve ka pasur marrëveshje për transportimin e mallit si dhe për qëndrimin e kamionit të bllokuar në terminalin e Tiranës dhe Vorës për periudhën nga data 04.04.2021 deri më 31.08.2021.

Kreditori po ashtu ka theksuar që fatura e lëshuar është e rregullt, meqenëse e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga personat përgjegjës të debitorit, duke shtuar që fatura është lëshuar në emër të transportit – kamionit të bllokuar në Terminalin Vorë në Shqipëri dhe se termi “copë”, i përdorur, është shënuar për ditët (një copë – një ditë) dhe kjo për faktin që programi i kreditorit ka njësi kalkulimi copën dhe se për këtë është dhënë sqarimi në komunikimet elektronike me debitorin. Ndërsa sa i përket pretendimit të debitorit lidhur me TVSH-në, ka theksuar që sipas zyrtarëve të ATK-së, faturimi shtesë për qëndrimin në Terminal nëse i faturohet furnitorit të brendshëm duhet të faturohet me TVSH.

I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të lejohet përmbartimi i kërkuar si në propozim. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, mirëpo nuk i ka specifikuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin KPPP.nr.1950/2022 të datës 29.09.2023 e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.34/2022 të datës 10.02.2022.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr.54/24 të datës 05.03.2024 ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka prishur aktvendimin KPPP.nr.1950/2022 të datës 29.09.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 269 e datës 01.09.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se dokumenti - Fatura Nr. 269 e datës 01.09.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i faturës dhe nuk mund të konstatohet se për çfarë shërbime është kërkuar përmbushja e borxhit nga ana e debitorit.

Deri tek ky vlerësim Gjykata erdhi pasi që nga Fatura nr. 269 e datës 01.09.2021, nuk mund të vërtetohet se për cilat shërbime është kërkuar borxhi, sepse në faturë detyrimi kërkohet në emër të “Transportit Vendor”, të përcaktuar në njësinë matëse “me copë” dhe “sasi”, ndërsa borxhi nga ana e kreditorit, kërkohet për ofrimin e shërbimeve të transportit nga Gjilani deri në Tiranë, përkatësisht në Terminalin e Vorës, si dhe në emër të bllokimit të kamionit në Terminalin e Vorës në Republikën e Shqipërisë, për periudhën kohore prej datës 04.04.2021 deri me datën 31.08.2021.

Andaj Gjykata vlerëson se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në rastin konkret, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarimit, meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara saktësisht shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, përkatësisht nuk dihet se për cilat shërbime është kërkuar borxhi në

fjalë dhe si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat duhet të anulohet.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarrimi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.464/24, datë 25.07.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.